



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.05.2025

Numër protokolli: 3298/2025

A.nr.406/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, me Çlirim Zeka, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.406/2025 të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Ç., duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.05.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.406/2025, e datës 03.03.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Ç.

II. Anulohet Vendimi Ref.02/Nr.25, i datës 07.02.2025, i ud. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit dhe në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke i kompensuar ankuesit për funksionet shtesë në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.Ç. (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 03.03.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.02/Nr.25, të datës 07.02.2025, të ud. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 07.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje referuar MINT), ndërsa kjo e fundit me datë 11.03.2025 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 15.04.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1380/2025 të datës 03.03.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit me Nr. 07/114 të datës 30.01.2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Qarkore rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për Funkcionin shtesë e datës 22.03.2025; Vendimin Ref.02/Nr.25, të datës 07.02.2025, të ud. Sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.03.2025; Përgjigje në ankesë e datës 11.03.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Emaili i datës 10.03.2025 nga Z.K për A.B; Rekomandim i datës 28.01.2025 lidhur me refuzimin e kërkesës për kompensim të datës 09.01.2025; Emaili i datës 06.03.2025 nga Z.K për A.B; Emaili i datës 06.03.2025 –kërkesë për përgjigje në ankesë; Emaili i datës 10.03.2025; Vendimit me Nr. 07/60 të datës 27.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimit me Nr. 08/121 të datës 25.01.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; ; Vendimit me Nr. 07/114 të datës 30.01.2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 15.04.2025 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga ankuesit në procedurë, ka konstatuar se ekzistojnë baza ligjore dhe rrethana të mjaftueshme juridike që lënda e ankuesit është e **bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2013 mban pozitën *Zyrtar i Logjistikës* në Ministrinë e Mbrojtjes. Tutje sipas provave të lëndës, sipas Vendimit me Nr. 07/114 të datës 30.01.2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është themeluar Komisioni për Licencimin e Mallrave dhe Shërbime Strategjike kur ankuesi ka qenë anëtar, me tej sipas Vendimit me Nr. 04/90 të datës 19.02.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është themeluar Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike e ku ankuesi është caktuar anëtar i këtij

komisioni, sipas Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit me Nr. 07/60 të datës 27.01.2021 gjegjësisht paragrafi 1, ashtu që M.Th. caktohet anëtar, ndërsa A.Ç. zëvendës anëtar. Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 27.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 07/60, me të cilin formohet Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, ndërsa në pikën 6 të këtij vendimi është shfuqizuar Vendimit me Nr. 04/90 i datës 19.02.2019 dhe Vendimit me Nr.11/15 i datës 20.07.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës përmes vendimit me Nr.01/197 të datës 29.03.2024 ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me Nr. 07/60 të datës 27.01.2021 dhe Vendimit me Nr.08/121 të datës 25.01.2023, ku është ndryshuar nën pika 1.8, ashtu që D.A. zëvendës anëtar zëvendësohet nga D.M., ndërsa është ndryshuar dhe plotësuar edhe pika t e Vendimit me Nr.08/121 të datës 25.01.2023 ashtu që E.P. zëvendësohet nga B.J.

Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike më datë 08.01.2025, ka kërkuar nga MINT, kompensimin për punë shtesë për pjesëmarrjen në këtë komision, mirëpo Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Funkcion Shtesë, sipas Rekomandimit të datës 28.01.2025, ka njoftuar se kompensimi nuk mund të realizohet sepse nuk janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë, ndërsa u.d. Sekretarja e Përgjithshme e MINT më datë 07.02.2025 ka nxjerr Vendim Ref.02/Nr.25, me të cilin ka refuzuar kërkesën për kompensim për punë shtesë të Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, me arsyetimin se lidhur me procedurën e miratimit nuk plotësohet neni 6 i Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë sepse: Institucioni që e themelon parasheh të drejtën për kompensim të anëtarëve të bordit apo komisionit dhe e përcjell tek Njësia përkatës për ekzekutim.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.02/Nr.25, të datës 07.02.2025, të ud. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë sepse është bazuar në një rekomandim të Komisionit për funksion shtesë i cili në mënyrë të gabueshme ka interpretuar nenin 6 të kësaj rregulloreje. Se komisioni i ka plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat ligjore kjo nuk është fare kontestuese por as nuk duhet të jetë kontestues kompensimi ngase sipas vendimeve për formimin e Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike ka qenë MINT që është obliguar të zbatoj dhe duhet të zbatoj vendimet e Kryeministrit. Kërkon nga Këshilli që të aprovohet dhe të kompensohet për funksion shtesë në mënyrë retroaktive nga muaj shkurt 2023 deri në muajin shkurt 2025.

Në kuptim të së drejtës së nëpunësi civil në kompensim për funksion shtesë, dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ju referua Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht:

-Nenit 35: *Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5.*

kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.

-Nenit 38: *1.Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3.Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.*

Po ashtu, Kolegji iu referua edhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, me theks të veçantë:

- Nenit 4, paragrafët 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *Kompensimi për funksionin shtesë 1. Zyrtari publik i cili emërohet/caktohet që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtari publik, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit...”*

-Nenit 5, paragrafi 2, ku parashihet se: *2. Përrjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar...”* si dhe

-Nenit 7, ku përcaktohet se: *1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i*

parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje

Nisur nga kuadri ligjor si me lartë si dhe duke u bazuar në provat materiale të çështjes, Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit për kompensim të funksionit shtesë, për faktin se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për kompensim të funksionit shtesë, rrjedhimisht, themelimi i Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike Rregulloren (QRK) Nr. 35/2013 për Funksionimin e Punës së Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, ku me këtë rregullore janë ë përcaktuar, kompetencat e kryesuesit dhe anëtarëve, përbërja, forma e punës, mbajtja e takimeve, procesverbalet e mbledhjes së komisionit, aprovimi i vendimeve të komisionit, raportimi dhe shqyrtimi i aplikacionit nga ana e komisionit, rrjedhimisht sipas Vendimit me Nr. 04/90 të datës 19.02.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është themeluar Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike e ku ankuesi është caktuar anëtar i këtij komisioni, sipas Vendimit me Nr. 11/15 të datës 22.07.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit me Nr. 04/90 të datës 19.02.2019 gjegjësisht paragrafi 1, ashtu që P.P. caktohet anëtar, ndërsa D.T. zëvendës anëtar. Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 27.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 07/60, me të cilin formohet Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, ndërsa në pikën 6 të këtij vendimi është shfuqizuar Vendimit me Nr. 04/90 i datës 19.02.2019 dhe Vendimit me Nr. 11/15 i datës 20.07.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022 ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me Nr. 07/60 të datës 27.01.2021, ku është ndryshuar nën pika 1.3 dhe 1.4, ashtu që B.K./MM dhe N.Z./MM, zëvendësohen nga Major M.Th./MM, anëtar dhe A.Ç./MM zëvendës anëtar, atëherë nga periudha kur ankuesi është caktuar anëtar i këtij komisioni sipas Vendimit me Nr.11/68 të datës 23.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, angazhimi i ankuesit në kuadër të Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike nuk bënë pjesë të detyrat e obligueshme të ankuesit që i ka sipas akt emërimit, por që përbënë funksion shtesë.

Përkitazi, me kriterin e përcaktuar më nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, Kolegji thekson faktin se Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, plotëson kushte ligjore kumulative sipas këtij neni, dhe duke marr parasysh faktin se sipas vendimeve të cekura më lartë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e tyre është obliguar MINT, mirëpo edhe përkundër faktit se sipas Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk është përcaktuar asnjë lloj kompensimin për kryesuesin dhe anëtarët e Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, atëherë në vlerësim të Kolegjit kjo e drejtë e garantuar me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, rrjedhimisht, pala në këtë rast ankuesi është duke e ushtruar funksionin shtesë të përcaktuar me një akt nënligjor dhe pa marr parasysh faktin se vendimi i themelimit a parasheh apo jo kompensim atëherë aktet ligjore dhe nënligjore parashohin një të drejtë të tillë, dhe nuk mund të merret si pretekst se meqë nuk është paraparë kompensimi në vendim nuk mund edhe të kompensohen. Kolegji i Këshillit, në rrjedhën e provave materiale të lëndës, sikurse është thënë më lartë, konstaton se pozita e ankuesit në kuadër të Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, përbën funksion shtesë dhe për këtë duhet paguar sipas rregullativës ligjore në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196

për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, për rrjedhojë edhe vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimin Ref.02/Nr.25, i datës 07.02.2025, i u.d. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është në kundërshtim me frymën ligjore dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Siç u tha me sipër, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Sekretaren e Përgjithshme të MINT, që ankuesit ti bëj kompensimin e funksionit shtesë lidhur me angazhimin si anëtar në Komisionin për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike në pajtim me mbledhjet e mbajtura dhe atë nga muaji shkurt 2023 kur ka filluar të aplikohet Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë deri në zbatimin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.406/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.Ç.;
- Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.